



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. *K2/540-6* Prot.  
Nr. Dok. 201901533/6

Tiranë *05/03/2020*

**Lënda :** *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.*

MINISTRIT TË BRENDSHËM  
Tiranë

*I nderuar Zoti Lleshaj,*

Së pari, nëpërmjet këtij komunikimi shpresoj dhe besoj që bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve tona për kryerjen me sukses të misioneve kushtetuese e ligjore për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtetasve do të ketë rritje të vazhdueshme.

Së dyti, më lejoni që t'ju parashtoj një rast të trajtuar nga institucioni ynë, i cili bën fjalë për shkeljen e të drejtave të një punonjësi policie, të cilin ia kemi bërë prezent Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, por që nuk është mirëpritur nga ana e tij.

Në Institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi \*\*\*  
Ankuesi shkruan se është punonjës i Policisë së Shtetit, me gradën policore "Kryekomisar", me detyrë Specialist në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin (Sektori i Imigracionit) dhe ka një karrierë prej 27 vitesh në Policinë e Shtetit. Gjatë punës në këtë organ ka shërbyer në disa detyra duke e nisur karrierën nga detyra e Komandantit të Togës dhe deri në detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Rajonale për Kufirin dhe Migracionin. Gjatë karrierës së tij ka qënë korrekt në zbatimin e akteve normative dhe detyrat e ngarkuara, ka punuar për ngritjen e tij intelektuale dhe profesionale, si dhe ka pasur rezultate të larta në punë.

Deri në datën 26.12.2013 ai ka mbajtur gradën "Drejtues" të cilën e ka fituar duke plotësuar të gjitha kriteret ligjore. Në muajin nëntor 2013 nga Sektori i Personelit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë i është kërkuar të uljet në gradë për mungesë të vendeve të lira në pozicionin me gradën "Drejtues". Nga ana e tij është pranuar kjo kërkesë me kusht rimarrjen e gradës brenda afatit 2 vjecar sipas kriterëve të përcaktuara në ligjin nr. 9749, datë 04.06.2007 "Për Policinë Shtetit".

Në datën 06.11.2013 ai i ka bërë kërkesë për uljen në gradë Drejtorit Përgjithshëm Policisë së Shtetit. Me urdhrin nr. 1861/3, datë 26.12.2013 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, ai është liruar nga detyra e Zv/Drejtor për Sigurinë



Publike dhe Shef Sektori i Rendit Publik në Drejtorinë e Policisë Qarkut Gjirokastrë, për ndryshim në strukturën organizative të Policisë dhe ulur në gradë nga “Drejtues” në “Kryekomisar” dhe ndërkohë është emëruar në detyrë Shef Sektori, në Sektorin e Shërbimeve Operacionale dhe Hetimit në Drejtorinë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit Tiranë.

Pas uljes në gradë ai ka konstatuar se ishin hapur vende të lira për gradën “Drejtues”, për të cilët ishin organizuar konkurse dhe se kishte disa punonjës policie që nuk kishin gradën që i përkiste funksionit organik me gradën “Drejtues”. Meqënëse ai nuk po e merrte emërimin sipas përcaktimeve ligjore dhe pas një muaji do të hynte në fuqi ligji i ri “Për Policinë e Shtetit” nr. 108/2014, në datën 13.02.2015 ka bërë kërkesë padë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me objekt:

“Detyrimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për ta ngritur në gradën e nivelit “Drejtues” dhe detyrimin që ta emërojë në një funksion të njëjtë me gradën e nivelit “Drejtues” në Policinë e Shtetit”.

Pas përfundimit të gjykimit të kësaj çështjeje, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1944, datë 14.04.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Ndërsa Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 5356 datë 14.02.2017 ka vendosur, “*Detyrimin e palës së paditur për t’i dhënë paditësit gradën “Drejtues” dhe emërimin në një funksion korrespondues të gradës “Drejtues”. Ky vendim përbën titull ekzekutiv, menjëherë të ekzekutueshëm nga Shërbimi Përmbarimor Gjyqësor*”.

Bazuar në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë ai ka bërë disa herë kërkesa drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ministrit të Brendshëm dhe Kryeministrit nëpërmjet portalit “Shqipëria që duam” për zbatimin e tij, por vendimi nuk është zbatuar ende.

Në njërën nga këto përgjigje të kthyer nga Drejtoria e Personelit dhe konkretisht atë me nr. 416/1 prot., datë 08.01.2018, ndër të tjera ai është informuar se, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ka bërë kërkesë për pezullim ekzekutimi të vendimit gjyqësor drejtuar Gjykatës së Lartë.

Ankuesi i ka kërkuar Gjykatës së Lartë informacion nëse ka kërkesë për pezullim të ekzekutimit të vendimit gjyqësor nr. 5356, datë 14.12.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Nga përgjigja e kthyer nga Gjykata e Lartë me shkresën nr. 664/1, datë 15.02.2018, ai është informuar se nuk është paraqitur ndonjë kërkesë me objekt pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor.

Ndodhur në rrethanat që vendimi gjyqësor i cituar më sipër nuk po zbatohet vullnetarisht, ai i është drejtuar me kërkesë Zyrës së Përmbarimit Gjyqësor “Real Bailiff Service” shpk. Nga kjo zyrë i janë bërë dy njoftime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për ekzekutimin e vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, respektivisht në datat 22.10.2019 dhe 14.11.2019, por përsëri ky vendim nuk është ekzekutuar ende.

Sipas ankuesit, qëndrimi i mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit duke mos bërë ekzekutimin e vendimit gjyqësor të cituar më sipër me pretendimin se nuk ka vende të lira për gradën “Drejtues”, është në kundërshtim me aktet normative në fuqi. Si pasojë e këtij qëndrimi atij i është dëmtuar karriera dhe integriteti, si dhe i është shkaktuar edhe një dëm i konsiderueshëm ekonomik për shkak të diferencës së pagës bruto që merr tani në gradën “Kryekomisar” e cila është në vlerën e 75.300 lekë në muaj, ndërkohë që paga bruto në gradën “Drejtues” është në vlerën e 106.209 lekë në muaj.

Ndërkohë ai pretendon se vazhdimisht në strukturat e Policisë së Shtetit ka pasur vende të lira për gradën policore “Drejtues” dhe se aktualisht ka 33 vende të lira. Ky



pretendim i tij bazohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 87, datë 13.09.2018 “Për hapjen e procesit të konkurimit për fitimin e 33 vende të lira”.

Përveç sa më sipër, në këtë ankesë ankuesi parashtroi se nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është mbajtur qëndrim me dy standarde lidhur me dhënien e gradës policore të fituar me vendime gjyqësore, sepse ka disa raste që oficerëve të policisë iu janë dhënë gradat e larta policore në zbatim të vendimeve gjyqësore, sikurse është bërë me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 33, datë 10.01.2019 “Për rikthimin në Policinë e Shtetit dhe emërimin në detyrë të një punonjësi policie me gradën “Drejtues” dhe me Urdhrin nr. 797, datë 26.04.2017 “Për dhënien e gradës policore në zbatim të një vendimi gjyqësor një punonjësi policie me gradën “Kryekomisar” në zbatim të vendimit nr. 903 80 2017 9210, datë 08.03.2017, të Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, i cili ka marrë formë të prerë në datën 09.04.2017. Gjithashtu sipas tij, gjatë periudhës që nga muaji dhjetor 2013 e deri aktualisht që ai është me gradën policore “Kryekomisar”, në strukturat e Policisë së Shtetit shumë persona mbajnë pozicione apo funksione duke qenë me gradë më të ulët sesa e ka funksioni organik. Në vijim të ankesës ai bën prezent disa raste konkrete të urdhrave të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe emrat e punonjësve të policisë për të cilët nuk përputhen pozicioni funksion-gradë dhe konkretisht:

1. Me Urdhrin nr. 728/1, datë 02.06.2014, Kryekomisar \*\*\* është ngritur në gradën “Drejtues”, ndërkohë që funksionit në të cilin është emëruar i korrespondonte grada “Drejtues i Parë”.

2. Me Urdhrin nr. 1660, datë 29.05.2014, Komisar \*\*\* është ngritur në gradën “Drejtues”, ndërkohë që funksionit në të cilin është emëruar i korrespondonte grada “Drejtues i Parë”.

3. Me Urdhrin nr. 1825/1, datë 01.12.2014, Kryekomisar \*\*\* është ngritur në gradën “Drejtues”, ndërkohë që funksionit në të cilin është emëruar i korrespondonte grada “Drejtues i Parë”.

4. Me Urdhrin nr. 2760/1, datë 06.11.2014 Kryekomisar \*\*\* është ngritur në gradën “Drejtues”, ndërkohë që funksionit në të cilin është emëruar i korrespondonte grada “Drejtues i Parë”.

Gjithashtu ankuesi përmend edhe disa punonjës policie, emrat e të cilëve i kemi cituar në kërkesën për shpjegime drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, që gjatë viteve 2013 e në vijim janë emëruar në funksione më të larta se sa gradat që kishin në kohën e emërimit të tyre.

Së bashku me ankesën ai na ka dërguar edhe fotokopje të vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe të korrespondencës që ka pasur lidhur me këtë çështje, si dhe të dokumentacionit ku mbështet pretendimet e tij.

Me shkresën nr. K2/S-40-2 prot., datë 06.12.2019 i kërkuam Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit verifikimin e kësaj ankese dhe dërgimin e një informacioni lidhur me pretendimet e parashtuara nga ankuesi.

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me shkresën nr. 9605/1 prot., datë 18.12.2019, ndërmjet të tjerave na informoi se:

“Lidhur me ekzekutimin e vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit i ka kërkuar Gjykatës së Lartë pezullimin e veprimeve përmbarimore, e cila ka regjistruar çështjen në datën 15.11.2019.

Ndërkohë sqarojmë se gradat në Policinë e Shtetit fitohen mbi bazën e funksioneve korresponduese për gradë dhe nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurrues dhe përfundimit me sukses të programit



përkatës të arsimim/trajnim, sipas përcaktimeve në nenin 54 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Në vendimin nr. 892, datë 21.12.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, përcaktohet numri i përgjithshëm i punonjësve të policisë me gradën “Drejtues”.

Aktualisht Policia e Shtetit ndodhet në pamundësi objektive të zbatimit të vendimit gjyqësor të sipërcituar për shkak se nuk disponon funksione të lira me gradë policore të fituar përmes vendimit gjyqësor.”

Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe të përgjigjes së dërguar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit vlerësuam se:

Ankesa e shtetasit \*\*\* është e drejtë dhe e bazuar në ligj. Atij i janë shkelur të drejtat e garantuara nga nenet 42/2 e 43/2 të Kushtetutës, dhe neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku parashikohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, si dhe dispozitat e Kodit Civil për të drejtën e përfitimit financiar nga rritja në gradë dhe për rrjedhojë edhe në funksion, për mbrojtjen e integritetit të tij, si dhe për vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore.

Kërkesa e bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit drejtuar Gjykatës së Lartë për pezullimin e veprimeve përmbarimore lidhur me ekzekutimin e vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, nuk është argument ligjor për mos zbatimin e këtij vendimi gjyqësor. Përderisa nga organet gjyqësore, respektivisht nga gjykata e vendit të ekzekutimit apo Gjykata e Lartë nuk është marrë ende ndonjë vendim për pezullimin e ekzekutimit të këtij vendimi gjyqësor konform neneve 610 dhe 615/a të Kodit të Procedurës Civile, atëhere nuk legjitimohet qëndrimi i mbajtur deri tani nga ky institucion lidhur me mos zbatimin e vendimit në favor të paditësit (kreditorit) \*\*\*

Detyrimi i organeve shtetërore për të ekzekutuar vendimet gjyqësore është parashikuar në Kushtetutë, respektivisht në nenin 142/3 të saj ku sanksionohet se: **“Organet shtetërore janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”**. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është pjesë e strukturave të organeve shtetërore dhe ka detyrimin që të zbatojë vendimin gjyqësor të cituar më sipër, menjëherë pas shpalljes së tij në datën 14.02.2017. Mirëpo nga ky organ, jo vetëm që nuk u zbatua vullnetarisht ky vendim gjyqësor, por ai nuk po zbatohet edhe pas vënies në lëvizje nga ana e palës kreditore të shërbimit përmbarimor.

Lidhur me këtë çështje ju sjellim në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në praktikën e saj ka theksuar se, *shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej jo efektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë.*

Gjykata Kushtetuese Shqiptare në disa vendime të saj e ka trajtuar problemin e zbatimit të vendimeve gjyqësore. Ajo ka theksuar se, ... *parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”*.

Gjithashtu kjo Gjykatë ka deklaruar se, ...*ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”*.



Disa nga këto vendime ku është trajtuar kjo çështje mund t'i përmendim si më poshtë:

Në vendimin nr. 20, datë 09.07.2009, gjykata shprehet se: *“Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj (neni 135, pika 1 i Kushtetutës). Gjykata ka konfirmuar më parë se gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për dhënien e drejtësisë. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 02.04.2008). Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohet të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 27.5.2004).*

Në vendimin nr. 1, datë 19.01.2009, gjykata shprehet se: *“Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Vendimi nr. 27, datë 20.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (Vendimi nr. 6, datë 31.03.2006 i Gjykatës Kushtetuese).*

Në vendimin nr. 75, datë 23.11.2017 Gjykata Kushtetuese ka theksuar se: *“... ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (shih vendimin nr.79, datë 27.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese).*

*Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarimin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.*

*Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (shih vendimin nr.79, datë 27.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese)”.*

Nëse Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk do të ishte dakord me veprimet e përmbaruesit gjyqësor, ka pasur të drejtën e ankimit në gjykatë, brenda 5 ditëve nga kryerja e veprimit, për kundërshtimin e veprimeve të përmbaruesit gjyqësor



në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile. Por nga përgjigjia e dërguar nga ky organ nuk rezulton që ta ketë ushtruar këtë të drejtë ligjore.

Nga qëndrimi i mbajtur në këtë rast nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili vjen në kundërshtim të plotë e të hapur me ligjin dhe me një vendimin gjyqësor të formës së prerë, ankuesit i janë shkaktuar dhe vazhdojnë që t'i shkaktohen pasoja juridiko-civile, dëme pasurore e jo pasurore. Kjo do të sjellë si pasojë rritjen e detyrimeve buxhetore për dëmin e shkaktuar dhe shpenzimet gjyqësore të organit debitor, në rastin konkret Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ndërkohë sjellim në vëmendje edhe pasojat që rrjedhin nga ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 "Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore". Sipas nenit 1 të këtij ligji, organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë, privatë, vendas a të huaj. Ndërsa në nenin 2 të tij jepet kuptimi dhe përkufizimi i përgjegjësisë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore". Sipas kësaj dispozite, *"Përgjegjësi jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore" kuptohet detyrimi i organeve të administratës shtetërore për të shpërblyer dëmin që këto të fundit i kanë shkaktuar interesave të personave privatë në ushtrim e sipër të funksioneve të tyre publike.* Në nenin 3, gërma "a", të ligjit parashikohet një nga rastet kur organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë privatë, *kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme.* Ndërsa në nenin 4, paragrafi i dytë dhe i tretë, të ligjit është parashikuar përgjegjësia vetjake e punonjësve të organeve të administratës shtetërore, sipas të cilit, *"Punonjësit e organeve të administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë privatë, kur vërtetohet se ata kanë vepruar me keqbesim.*

*Në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar".*

Gjithashtu ligji i cituar më sipër, në nenet 1 dhe 8 të tij parashikon edhe dëshpërblimin moral të atyre që dëmtohen nga organet e administratës shtetërore, i cili konkuron me dëmshpërblimin pasuror dhe me dëmshpërblimet e tjera jopasurore.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"* dhe në nenin 21/b, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", në të cilin thuhet se: *"Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive"*, me shkresën nr. K2/S40-4 prot., datë 30.01.2020, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit i rekomanduam:

*"Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në favor të punonjësit të Policisë së Shtetit \*\*\* duke i dhënë gradën "Drejtues" dhe emërimin e tij në një funksion korrespondues të gradës "Drejtues"".*

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me shkresën nr. 103/3-S prot., datë 14.02.2020, na dërgoi të njëjtën përgjigje të dërguar edhe më parë me shkresën nr. 9605/1 prot., datë 18.12.2019, të cilën e kemi cituar më lart. Në thelb të përgjigjes së dërguar ishte refuzimi i rekomandimit tonë për të ekzekutuar vendimin gjyqësor në favor të kreditorit \*\*\*

Me keqardhje konstatojmë se përgjigjia e kthyer nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk reflekton respektim të akteve normative në fuqi dhe të



jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë.

Meqënëse Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nuk e ka pranuar rekomandimin tonë, për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura ankuesit, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”, si dhe nenin 21/c të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen;”

### **REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave të nevojshme, në cilësinë e organit epror të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për zbatimin e menjëhershëm të vendimit nr. 5356, datë 14.02.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë në favor të punonjësit të Policisë së Shtetit \*\*\* duke i dhënë atij gradën “Drejtues” dhe emërimin në një funksion korrespondues të gradës “Drejtues”.

Për qëndrimin që do të mbani ndaj këtij rekomandimi dhe masat që do të merrni për zbatimin e tij, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor 30 ditor të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar.


*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**AVOKATI I POPULLIT**

  
**Erinda Ballanca**

Konceptoi S. Nushi

Miratoi E. Ruspi

  
16.02.20